STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 8 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIHAPJEN E TUNELIT TE KUINS MIDTAUN (QUEENS MIDTOWN) PER TRAFIKUN

Rimëkëmbja e shpejtë e tunelit do të lehtësojë udhëtimet nga Long Ajlënd (Long Island)

Vendosen kufizime për kamiona ndërsa riparimet vazhdojnë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Tuneli i Kuins Midtaun (Queens Midtown) i Autoritetit të Transportit Metropolitan (MTA), që u përmbyt gjatë Uraganit Sendi (Hurricane Sandy), do të rihapet për shoferat në kohë për orën e pikut të mëngjesit të së premtes.

Tuneli do të rihapet në 6 të mëngjesit me dy korsi të hyrjes dhe dy të daljes. Asnjë kamion nuk do të lejohet që të përdorë tunelin. Rihapja do të lehtësojë udhëtimet për shoferët që hyjnë në Manhatan nga Kuins dhe Long Ajlënd, të cilën nuk kanë qënë në gjendje të përdorin tunelin që kur goditi stuhia.

“Rimëkëmbja e rrjetit të transportit të Nju Jorkut vazhdon,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Heqja e ujit me pompë nga ky tunel, rindërtimi i sistemeve të tij dhe rikthimi i tij tek banorët e Nju Jorkut ishte një arritje e pabesueshme dhe udhëtarët do të fillojnë të shohin rezultatet nesër në mëngjes.”

Tuneli i Kuins Midtaun (Queens Midtown) u rihap i kufizuar për autobusat ekspres të martën në mëngjes. Kamionat ende nuk lejohen në tunel deri në një njoftim tjetër. Ai mbetet subjekt i mbylljeve gjatë natës ndërsa ekipet vazhdojnë të riparojnë dëmin e konsiderueshëm në sistemin mekanik, të ajrimit, ndriçimit, komunikacioneve dhe sistemeve të tjera të shkaktuara nga përmbytja.

“Rikthimi i Tunelit të Kuins Midtaun (Queens Midtown) dukej si një punë e pamundur pas stuhisë, por punëtorët e Urave dhe Tuneleve të MTA-së kanë bërë të pamundurën,” tha Kryetari dhe CEO i MTA-së Jozef J. Lota (Joseph J. Lhota). “Ata kanë punuar pa pushim për të rikthyer një lidhje të rëndësishme në rrjetin e transportit të Nju Jorkut dhe për të ndihmuar në kthimin e Nju Jorkut në normalitet.”

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian